



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 tetor 2017
Nr. ref.: 1138/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin Nr. KI64/17

Parashtrues

Selatin Ahmeti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë së Kadastrit
në Komunën e Prishtinës, nr. 011-952-1/4261/16,
të 27 shkurtit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Selatin Ahmeti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Konkluzioni i Drejtorisë së Kadastrit në Komunën e Prishtinës, nr. 011-952-1/4261/16 (në tekstin e mëtejme: Drejtoria e Kadastrit), i 27 shkurtit 2017, me të cilin është pezulluar përkohësisht bartja e paluajtshmërisë në emër të parashtruesit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 6 qershor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Më 19 qershor 2017, një kopje e kërkesës iu dërgua edhe Drejtorisë së Kadastrit.
8. Më 5 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 dhjetor 2008, parashtruesi i kërkesës kishte blerë një banesë në Prishtinë, dhe kontratën e shitblerjes e kishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë (Vendimi 86/2009, i 8 janarit 2009).
10. Në një datë të paspecifikuar, banesa të cilën parashtruesi e kishte lëshuar me qira, si lokal afarist, u mbyll nga Inspekcioni Komunal i Prishtinës për arsye se nuk ishte realizuar bartja e pronës në emër të parashtruesit.

11. Më 16 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kërkesë për bartjen e paluajtshmërisë në Drejtorinë e Kadastrit.
12. Më 27 shkurt 2017, Drejtoria e Kadastrit (Konkluzioni nr. 011-952-1/4261/16) vendosi që deri sa të realizohet dorëzimi i provave plotësuese nga ana e parashtruesit, përkohësisht ta pezullojë bartjen e paluajtshmërisë.
13. Drejtoria e Kadastrit kërkoi si në vijim: *“[...] brenda afatit ligjor prej 15 ditë pune nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, të bëni plotësimin e kërkesës me këto dokumente: [...] duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, të sillet transferi bankar i kompletuar, ashtu siç kërkohet në bazë të këtij ligji i shumës [...] në mes të shitësit dhe të blerësit [...]”*.
14. Konkluzioni i Drejtorisë së Kadastrit po ashtu përcaktoi që parashtruesit i *“lejohet kundër këtij konkluzioni në afat prej 15 ditë pune, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet dhe dorëzohet ZKK-ës [Drejtorisë së Kadastrit] për rishqyrtim.”*
15. Më 13 mars 2017, kundër konkluzionit të lartpërmendur parashtruesi paraqiti ankesë në Drejtorinë e Kadastrit.
16. Deri me këtë datë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar njoftimin apo vendimin lidhur me ankesën e tij në procedurë administrative.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
18. Përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, parashtruesi pretendon që *“[...] Mosshfrytëzimi dhe mosdisponimi i lirë i pronës, mosadministrimi i mirë i drejtësisë, kompleksiteti i jashtëzakonshëm i një procedure administrative për të arritur në një vendim të drejtë, stërzgjatja e procesit, respektivisht qarja dhe mosvendosja e kontestit në një afat të arsyeshëm edhe pse dihet se gjykatat në procesin e stërzgjatur vendosin në favorin tim, ndërsa stërzgjatja ka pasoja të papara.”*
19. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: *“[...] të merr vendim se janë shkelur të drejtat e kërkuarit të garantuara me Kushtetutë që kanë të bëjnë me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [...]”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

22. Gjykata, gjithashtu, i referohet paragrafit 2 të nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

“2.Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata më tej i referohet pikës (1) (b) të rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse
[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

[...]”

24. Gjykata në bazë të shkresave të lëndës vëren se, ankesa e parashtruesit është ende në shqyrtim e sipër pranë Drejtorisë së Kadastrit.
25. Duke marrë për bazë faktin që rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt administrative pranë Drejtorisë së Kadastrit, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.
26. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës nuk e mohon faktin se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, por sipas tij shterimi mjeteve efektive pranë organeve kompetente, përfshirë edhe gjykatat e rregullta, është joefektiv për arsye se mund të rezultojë në stërzgjatje të procedurave.
27. Megjithatë, Gjykata, duke ju referuar praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), thekson se kohëzgjatja e procedurave, në vetvete, nuk e bën joefektiv mjetin juridik. (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI145/15, *Florent Muçaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 majit 2016, paragrafi 34).

28. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit se në rastin e tij mjetet juridike nuk janë efektive, Gjykata vëren se ai nuk ofron prova konkrete që mbështesin supozimin e tij.
29. Vetëm pretendimi i tij i thjeshtë për stërzgjatje të mundshme të procedurës paraprakisht nuk mund të shërbejë si argument për të vlerësuar efektivitetin e mjeteve juridike (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI145/15, *Florent Muçaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 majit 2016, paragrafi 35).
30. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI07/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010).
31. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, pa iu dhënë mundësia organeve kompetente, përkatësisht Drejtorisë së Kadastrit, për të përfunduar procedurat lidhur me ankesën e parashtruesit që është në vazhdim e sipër.
32. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar mjetet juridike siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, si dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi